



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:224287
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06767233

C.nr.4747/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjykatësit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: S.(B).B nga fshati M, Komuna K, të cilin në bazë të autorizimit (prokurës) e përfaqëson A.K, avokat me seli në P, kundër të paditurës: Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar në bazë të autorizimit (prokurës) nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë “P.J” dhe “T & P”, me përfaqësuese R.F, me objekt të kontestit: vërtetimin e të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor - publik në rigjykim me datë 10.01.2025, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe paditësit personalisht, me datë 28.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET E PABAZUAR në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.(B).B nga fshati M, Komuna K, përmes së cilës ka kërkuar nga Gjykata që të: *“APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S.B.B nga fshati M, Komuna K, tani nga P, ashtu që: VËRTETOHET se paditësi është pronar në bazë të kontratës mbi dhuratën dhe mbajtjes të ngastrës kadastrle P.K- P,71914059-07644-0, zona kadastrale Prishtinë, që evidentohet në emer të paditurës si zonë urbane, Tokë Bujqësore arë e klasës së parë në vendin e quajtur “R.M”, në sipërfaqe prej 8940 m2, që sipas gjendjes faktike në terren përbëhet prej këtyre pikave:*

- prej pikës 1-2, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.03m;
- prej pikës 2-3, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.72m;
- prej pikës 3-4, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 29.02 m;
- prej pikës 4-5, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.01 m;
- prej pikës 5-6, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 22.89 m;
- prej pikës 6-7, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 6.11 m;
- prej pikës 7-8, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.74 m;
- prej pikës 8-9, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 7.29 m;
- prej pikës 9-10, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 2.97 m;
- prej pikës 10-11, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 11.70 m;
- prej pikës 11-12, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.57 m;
- prej pikës 12-13, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 13.08 m;
- prej pikës 13-14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.27 m;
- prej pikës 14-15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 18.61 m;
- prej pikës 15-16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.63 m;
- prej pikës 16-17, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.40 m;

-prej pikës 17-18, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.65 m;
-prej pikës 18-19, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 24.71 m;
-prej pikës 19-20, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 11.23 m;
-prej pikës 20-21, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 13.33 m;
-prej pikës 21-22, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 19.53 m;
-prej pikës 22-23, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.77 m;
-prej pikës 23-24, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 4.22 m;
-prej pikës 24-25, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 9.39 m;
-prej pikës 25-26, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.58 m;
-prej pikës 26-27, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 5.51 m;
-prej pikës 27-28, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 11.74 m;
-prej pikës 28-29, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 18.43 m;
-prej pikës 29-30, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 17.54m;
-prej pikës 30-31, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.79 m;
-prej pikës 31-32, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 8.06 m;
-prej pikës 32-33, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 14.90 m;
-prej pikës 33-34, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 17.39 m;
-prej pikës 34-35, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 7.37 m;
-prej pikës 35-36, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 15.08 m;
-prej pikës 36-37, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 28.90 m;
-prej pikës 37-38, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 30.14 m;
-prej pikës 38-39, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 18.50 m;
-prej pikës 39-40, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 10.95 m;
-prej pikës 40-41, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 26.34 m;
-prej pikës 41-1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 23.27 m;

-Ngastra kadastrale 7644-0, sipas planit dhe elaboratit kadastral kufizohet me këto NK: nga ana veriore me NK nr 7772-1, e cila evidentohet në emër të paditurës si rrugë e pa kategorizuar; Në anen lindore me nk 7645-2 evidentohet në emër të B.G nga P, ngastrën Kadastrale 7645-3 në emër të B.G nga P, NK 7645-4 në emër të I.G nga P, NK 10105 evidentohet në emër të paditurës dhe NK 10105-2 në emër të A.G nga P; Nga ana jugore NK 7775-0 evidentohet në emër të PSH. Ujërat e Komunës së Prishtinës dhe nga ana perëndimore me NK 7643-0 në emër të të paditurës; **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës, që këtë të drejtë t'ia pranojë paditësit; **DETYROHET** Drejtoria e Gjeodezisë në Prishtinë, që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ta bëjë bartjen e pasurisë sipas këtij aktgjykimi.”

II. Secila palë i bartë shpenzimet veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Pranë ish - Gjykatës Komonale në Prishtinë, fillimisht është inicuar procedura kontestimore sipas padisë së paditësve B.B, N.B dhe F.H nga K, kundër të paditurës B.SH “Hortikultura”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë, lëndë kjo e cila është evidentuar nën shenjë C.nr.1345/08.

Përmes parashtresës së dt.15.04.2019, është bërë ndryshimi i padisë në aspektin subjektiv, në atë mënyrë që në cilësinë e palës paditëse ka hyrë S.(B).B nga fshati M, Komuna K, ndërsa në cilësinë e palës së paditur Komuna e Prishtinës, ndryshim ky i cili është lejuar nga ana e Gjykatës përmes aktvendimit procedural në procesverbalin e seancës përgaditore të mbajtur me datë 21.10.2019. Përmes parashtresës së deponuar me dt.05.02.2020, është bërë precizimi i padisë në aspektin objektiv, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes aktgjykimit C.nr.1245/08, të dt.05.02.2020, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës së parashtuar nga i autorizuari i paditësit, përmes aktvendimit Ac.nr.4497/2020, të dt.03.08.2023, e ka anuluar aktgjykimin e lartëcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1245/08, të dt.05.02.2020, duke e kthyer lëndën në të njejtën Gjykatë në rigjykim dhe vendosje. Me këtë rast, lënda ka marrë numrin C.nr.4747/23.

Në riprocedim, përgjatë seancave gjyqësore të mbajtura dhe në fjalë përfundimtare, të deponuar në formë të shkruar me dt.17.01.2025 paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke pretenduar se është fakt i pa mohueshëm që babai i paditësit O.(B).B, tani i ndjerë, lidhur me ngastën kontestuese kishte firmosur kontratën mbi dhuratën VR.nr.428/64, të dt.01.03.1964, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, i njejtë me familjen e tij ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirshëm të paluajtshmërisë dhe në të njejtën ka ndërtuar dy shtëpi banimi individual me material të fortë ndërtimor, pa u penguar nga askush. Tutje pretendohet se fakti që F.(H).K ka qenë pronare e ngastrës vërtetohet nga fleta poseduese nr.2849, e dt.28.02.1961, ndërsa fakti se pas lidhjes së kontratës së lartëcekur, paluajtshmëria është evidentuar në emër të të ndjerit O.(B).B, vërtetohet nga fleta poseduese nr.2849, e dt.09.07.1964. Mbi bazën e këtyre provave, sipas palës paditëse vërtetohet fakti që pasuria e dhuruar nga dhuratdhënësja sipas kontratës mbi dhuratën është regjistruar në librat kadastralë në emër të babait të paditësit. Tutje pretendohet se nga provat e administruara rezulton që e paditura, para datës 01.03.1964 asnjëherë nuk ka qenë pronare e paluajtshmërisë kontestuese, pasi të njejtën babai i këtu paditësit e kishte fituar në bazë të kontratës mbi dhuratën. Më tej pretendohet se Gjykatës i është prezantuar një aktgjykim, i cili për nga natyra është i njejtë me çështjen kontestuese, ndërsa sa i përket aktvendimit 07 Nr.464-32/78, të dt.06.07.1978, sipas palës paditëse vetëm vërtetohet fakti që është bërë transferimi i pronës tek e paditura për nevojat e Kompanisë "Hortikultura", mirëpo pas marrjes së këtij aktvendimi, e paditura asnjëherë nuk ka kërkuar nga paditësi lirim të paluajtshmërisë, duke shtuar se paluajtshmëria kontestuese pa kurrfarë bazë juridike evidentohet në emër të të paditurës. Pretendimet e lartëcekura, sipas palës paditëse janë vërtetuar edhe nga nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmia e gjeodezisë, e punuar nga eksperti Q.H me dt.04.12.2019. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, ashtu siç është precizuar në parashtresën e dt.05.02.2020.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në fjalë përfundimtare.

Pala e paditur, përmes përfaqësueses së autorizuar, përgjatë seancave gjyqësore të mbajtura në riprocedim dhe në fjalë përfundimtare të deponuar në formë të shkruar me dt.17.01.2025, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Fillimisht pretendohet që pala paditëse nuk ka arritur të provojë pretendimet e theksuara në padi me prova konkrete materiale, duke shtuar se për të paditurën nuk ka qenë kontestues fakti se pasuria e cila përbën objekt kontesti ka qenë e evidentuar

në emër të O.(B).B, mbi bazën e kontratës së vitit 1961, mirëpo me datë 06.07.1978, ngastra kontestuese është ekspropriuar përmes aktvendimit të Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.466-32/78. Mbi këtë bazë, pretendohet se Komuna e Prishtinës, përmes një vendimi administrativ i cili ka deivuar në bazë të procedurës së ligjshme administrative është bërë pronare e ngastrës kontestuese, e cila tani evidentohet si ngastra nr.7644-0, ZK Prishtinë. Sa i përket provës së bashkangjitur nga pala padiëse - aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.844/06, i datës 10.07.2006, përmes së cilit pretendohet se trajton të njejtën gjendje faktike për faktin se bëhet fjalë për një paluajtshmëri fqinje, është propozuar që të njejtës provë të mos i falet besimi, për faktin se kemi të bëjmë me bazë tjetër juridike nga ajo e cila paraqitet si objekt shqyrtimi. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, mirëpo jo në formën e specifikuar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata gjatë seanës së shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me dt.10.01.2025, ka administruar provat si vijon:

Vendimi për Rithemelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale “Hortikultura” në Prishtinë, i dt.29.12.2005; Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë T.nr.55/2009, i dt.14.09.2009; Kontrata për dhuratën, VR.nr.428/61, e dt.28.02.1961, e lidhur në mes të F.(H).K dhe O.(B).B; Procesverbali i këqyrjes në vend, i përpiluar me dt.08.11.2019; Ekspertiza nga lëmia e gjeodezisë, e përpiluar nga eksperti Q.H, me dt.04.12.2019 së bashku Skicën e matjeve gjeodezike; Kërkesa e dt.15.03.2024, e përpiluar nga Komuna e Prishtinës, drejtuar Arkivit Ndërkomunal; Fleta poseduese nr.2849, e dt.28.02.1961; Fleta poseduese nr.2849, e dt.09.07.1964; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të palës, Nr.7-464-32/78-4, i përpiluar me datë 08.06.1978; Aktvendimi i Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, i dt.06.07.1978; Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.844/06, i datës 10.07.2006.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilit pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit 03-L/006 të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes të veçantë dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç si dhe të gjitha ato së bashku, me ç’rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Fillimisht, është me rëndësi të sqarohet se udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit të Kosovës përmes aktvendimit Ac.nr.4497/2020, të dt.03.08.2023, kanë qenë të orientuara drejt vërtetimit të rrethanave kyçe si në vijim:

- Vërtetimin e faktit se kush ka qenë pronar i ngastrës kontestuese në kohën kur është lidhur kontrata mbi dhuratën VR.nr.428/61 e datës 01.03.1961;
- Vërtetimin e faktit se kur është bartuar pronësia e ngastrës kontestuese tek Komuna e Prishtinës, respektivisht në çfarë mënyre;
- Vërtetimin e faktit nëse është zhvilluar procedurë e eksproprijimit lidhur me ngastrën lëndore.

Në bazë të fletës poseduese Nr.2849, të datës 28.02.1961, rezulton që ngastra kadastrale e evidentuar si ngastra nr.3927/2, në atë kohë është evidentuar në emër të personit fizik - F.(H).K.

Nga Kontrata mbi Dhuratën, e vërtetuar pranë Gjykatës kompetente, me numër VR.nr.428/61 e datës 01.03.1961, e lidhur në mes të F.(H).K në cilësi të dhuratëdhënëses dhe O.(B).B në cilësi të dhuratëmarrësit, Gjykata gjeti se palët kontraktuese ishin pajtuar që ngastra kadastrale nr.3927/2, në vendin e quajtur “Ç.B” në sipërfaqe prej 0,80.57 ha, t’i jepet si dhuratë O.(B).B.

Nga fleta Poseduese Nr.2849, e datës 09.07.1964, Gjykata gjeti se parcela kadastrale me numrin 3927/2, është evidentuar në emër të O.(B).B.

Nga Procesverbali mbi marrjen në pyetje të palës, Nr.7-464-32/78-4, i përpiluar me datë 08.06.1978 nga ana e Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Gjykata gjen se O.(B).B ishte njoftuar për iniciimin e procedurës së ekspropriimit të parcelës kontestuese, nuk e kishte kundërshtar procedurën e ekspropriimit dhe kishte kërkuar kompensimin real të pronës që do t’i eksproprijohet.

Nga Aktvendimi i Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, i datës 06.07.1978, Gjykata gjeti se disa ngastra kadastrale, përfshirë edhe ngastra kontestuese nr.7644, arë e klasës 1, me sipërfaqe prej 0,89.40 ha, e evidentuar në emër të O.(B).B, është eksproprijuar në favor të Ndërmarrjes Publike Komunale “Hortikultura”, me qëllim të ndërtimit të kompleksit “Hortikultura” dhe parkut rekreativ në KK Prishtinë.

Nga Vendimi për Rithemelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale “Hortikultura” në Prishtinë, i datës 29.12.2005, Gjykata gjeti se sipas nenit 5 të këtij aktvendimi, e gjithë paluajtshmëria e regjistruar në emër të ish - Ndermarrjes Publike Komunale “Hortikultura”, para miratimit të këtij Aktvendimi, do t’i kthehet Komunës së Prishtinës dhe do të bëhet ndryshimi i titullarit të së drejtës tek Komuna e Prishtinës në evidencat kadastrale.

Nga Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë T.nr.55/2009, i datës 14.09.2009, Gjykata gjeti se pas vdekjes së të ndjerit O.(B).B, si trashëgimtar i vetëm ligjor i të njejtit është shpallur nipi i trashëgimlënësit - këtu paditësi S.B. Gjykata vëren se në listën e pasurisë trashëgimore të evidentuar me këtë aktvendim, nuk është përfshirë parcela kadastrale kontestuese në këtë çështje kontestimore.

Gjatë procedimit të mëhershëm, sipas propozimit të palës paditëse është caktuar nxjerrja e provës përmes këqyrjes në vend me ekspertizë nga lëmia e gjeodezisë, me ç’rast për ekspert është caktuar Q.H. Seanca e këqyrjes në vend është mbajtur me dt.08.11.2019, ndërsa eksperti përkatës ka përpiluar mendimin dhe konstatimin me shkrim me dt.04.12.2019.

Në procesverbalin e këqyrjes në vend, të përpiluar me datë 08.11.2019, fillimisht është konstatuar se pas daljes në vendin e ngjarjes, numri i ngastrës kadastrale nuk mund të identifikohet saktë, ngase ky numër ka të bëjë me matjet shtetërore të vitit 1947 të cilat mungojnë, kurse sipas gjendjes faktike parcela duhet të identifikohet sipas matjeve të vitit 1957, të cilat janë ende të aplikueshme. Tutje në këtë procesverbal është konstatuar se në ngastrën lëndore janë të ndërtuara 2 shtëpi të banimit individual me etazhitet B+P+NK.

Në mendimin dhe konstatimin me shkrim, fillimisht është konstatuar se pas verifikimit të dokumentacionit, sipas evidencës në elaboratin kadastral, kontesti ka të bëjë me ngastrën nr.7644-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: shoqërore, zona: urbane (U), lloji i shfrytëzimit të parcelës: tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: arë e klasit të parë, vendi i quajtur “R.M”, sipërfaqja e përgjithshme 8940 m², e evidentuar në posedim - P.Sh, Kuvendi Komunal Prishtinë. Tutje është konstatuar se Komuna e Prishtinës, këtë paluajtshmëri e ka eksproprijuar në bazë të aktvendimit të Sekretariatit për Financa, Nr.07-464-32/78, të dt.06.07.1978, për nevoja të Ndërmarrjes “Hortikultura”, e cila e ka pasur në shfrytëzim deri në vitin 2005, kur me Vendimin Nr.01-330-659, të datës 29.12.2005, me rithemelimin e Ndërmarrjes Publike Komonale “Hortikultura” në Prishtinë, e drejta e shfrytëzimit i është kthyer Komunës së Prishtinës. Më tej në ekspertizë është konstatuar se ngastra kadastrale nr.7644-0, është eksproprijuar nga paraardhësi i paditësit O.(B).B, ndërsa këtu paditësi S.(B).B e ka në shfrytëzim faktik tërë ngastrën. Tutje në këtë ekspertizë është evidentuar kontrata mbi dhuratën e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prishtinë, VR.nr. (OV.br.) 428/64, e dt.01.03.1964, duke shtuar se në kohën e lidhjes së kësaj kontrate janë aplikuar matjet shtetërore të vitit 1947, kur numri i ngastrës është evidentuar 3927/2, në sipërfaqe 0.80.27 ha, kurse me matjet e vitit 1957, të cilat kanë filluar të aplikohen në fillim të vitit 1967 dhe janë edhe tani të aplikueshme, ngastra ka marrë numrin e ri 7644-0, në sipërfaqe prej 8940 m². Tutje është konstatuar se numri i ngastrës 7644-0, ZK Prishtinë, sipas matjeve të vitit 1957, i përgjigjet numri të ngastrës kadastrale 3927/2, ZK Prishtinë, sipas matjeve të vitit 1947, ndërsa ndryshimi në sipërfaqe është arsyetuar me faktin se metoda e matjeve dhe pajisjet për llogaritje të sipërfaqeve kanë qenë më të avancuara. Në vijim të ekspertizës janë pasqyruar dimensionet e pjesës shfrytëzuese të ngastrës kadastrale nr.7644-0 si dhe kufijtë e kësaj ngastre, ndërsa tutje është konstatuar se para vitit 1999, në programin e quajtur “BORMEN”, nga të dhënat që disponon Drejtoria për Kadastër në Prishtinë, ka qenë e evidentuar në emër të P.sh Kuvendi Komunal Prishtinë, por këto të dhëna janë vetëm nga sistemi elektronik, pasi të dhënat tjera nuk janë në dispozicion dhe gjenden në shtetin e Serbisë.

Gjykata bëri shtjellimin e të gjitha provave të administruara, kurse në arsyetimin e aktgjykimit, iu referua provave që kishin relevancë të drejtpërdrejtë dhe ndikim vendimtar në shqyrtimin dhe vendosjen përkitazi me këtë çështje juridike kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- *Vlerësimi i Gjykatës* -

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 10.01.2025, në kuptim të vërejtjeve të dhëna përmes aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykatës fillimisht i ka rezultuar se para eksproprijimit të ngastrës kadastrale kontestuese, të drejtën e pronësinë në këtë ngastër e mbante gjyshi i këtu paditësit - personi fizik O.(B).B, i cili pronësinë e kishte fituar në bazë të titullit juridik - Kontratës mbi Dhuratën, e vërtetuar pranë Gjykatës kompetente, me numër VR.nr.428/61 e datës 01.03.1961. Kontrata në fjalë ishte lidhur në mes të F.(H).K, në cilësi të dhuratëdhënësës dhe O.(B).B në cilësi të dhuratëmarrësit, ndërsa objekt i kësaj kontrate ishte ngastra kadastrale e cila në atë kohë është evidentuar si ngastra numër 3927/2. Në ndërkohë, ngastra e lartëcekur kishte marrë numrin 7644-0, ndërsa i është nënshtruar procedurës së eksproprijimit sipas aktvendimit të Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, i datës 06.07.1978. Ngastra aktualisht evidentohet si pronë shoqërore, në pronësi të të paditurës - Komunës së Prishtinës, fakt ky i cili nuk kontestohet nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse dhe për më tepër është sqaruar përmes ekspertizës nga lëmia e gjeodezisë, e përpiluar nga eksperti Q.H.

Kur është fjala për ekspertizën e lartëcekur, Gjykata të njëjtës ia fali besimin e plotë, për faktin se është përpiluar mbi bazën e të gjitha parametrave dhe standardeve profesionale, është në përputhje me provat tjera materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe i shërben Gjykatës në drejtim të vërtetimit të rrethanave dhe fakteve kyçe për vendosjen e kësaj çështje. Për më tepër, të gjeturat e kësaj ekspertize nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në cilëndo fazë të procedurës.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe argumentimet e parashtruara gjatë seancave gjyqësore të mbajtura, vështruar edhe nga faktet dhe provat që dërguan deri tek gjendja e tillë faktike e vërtetuar, çështje kontestuese midis palëve ndërgjyqëse që paraqet edhe fokusin kryesor të Gjykatës për argumentim juridik paraqet çështja e eksproprijimit të parcelës kontestuese me *efektet juridike* që sjellë e njëjta, si dhe kontestues mbetet fakti nëse paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë të pretenduar në dy baza juridike të ndryshme: së pari sipas Kontratës mbi Dhuratën e vërtetuar pranë gjykatës kompetente me numër VR.nr.428/64, e datës 01.03.1961 dhe së dyti mbi bazën e mbajtjes - parashkrimit fitues, fakte këto për të cilat palët ndërgjyqëse kanë ngritur pikëpamje diametralisht të kundërta nga njëra-tjetra.

Gjykata fillimisht e sheh të nevojshme të sqarojë se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, duke iu referuar parashtrësës së dt.05.02.2020, ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi dy baza: punës juridike dhe parashkrimit fitues, për çka kjo Gjykatë vlerëson se nuk mund të vërtetohet ekzistimi i drejtës së pronësisë njëkohësisht me dy baza juridike, *argumentum a contrario*, vërtetimi i drejtës së pronësisë bëhet vetëm me një bazë. Në anën tjetër, Gjykata duke u bazuar në parimin “*iura novit curia*” - “*Gjykata e njeh të drejtën*” i paraparë me nenin 2 par.2 të LPK-së, ku parashihet që: “*Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale*”, i vlerëson faktet dhe këto fakte i kualifikon në *normat juridike* relevante të së drejtës materiale të aplikueshme, dhe varësisht epilogut të këtij shqyrtimi, vendosë meritorisht për çështjen juridike përkatëse, pa qenë e kufizuar nga argumentet e sjella nga palët ndërgjyqëse. Në formën më të përhapur, parimi i lartcekur, i lejon gjykatës të bazojë vendimin e saj mbi një përcaktim të drejtë ligjor që nuk ka qenë subjekt i argumenteve nga palëve ndërgjyqëse. Me fjalë të tjera, Gjykata është vetë *zotëruese* e karakterizimit që i jep fakteve në pikëpamje të aplikimit të rregullave të së drejtës materiale. Në këtë kuptim, Gjykata në procesin gjyqësor civil, vlerëson nëse çështja duhet të trajtohet në këndvështrim të një drejte ose standardi të caktuar të së drejtës materiale, pavarësisht faktit se palët ndërgjyqëse *së pari* a janë thirrur në ndonjë normë juridike apo standard juridik të njohur ose jo dhe *së dyti* pavarësisht faktit se mbi çfarë norme juridike ose standardi juridik të njohur i kanë mbështetur kërkesat e tyre.

- *Sfondi juridik kushtetues dhe ndërkombëtar përkitazi me të drejtën e pronësisë* -

Në shqyrtimin dhe vendosjen meritorie të rastit konkret kontestimor, Gjykata fillimisht i referohet Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku në nenin 46 të saj parashihet se: “*1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, ne pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet* “. Po ashtu, Gjykata ka në konsideratë edhe detyrimin

kushtetues i cili buron nga neni 53 i Kushtetutës, i cili parasheh që: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e Këshillit të Evropës, e datës 04.11.1950, e miratuar në Romë, si dhe Protokolleve shtesë të saj (këtu e tutje referuar si “KEDNJ”) të cilat *instrumente ndërkombëtare* janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në rendin juridik të Republikës së Kosovës *per constitutionem* sipas nenit 22 par.2 të Kushtetutës.

Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së parashihet që: “*1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare 2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera*”.

Gjykata nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), ka gjetur se neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ-së, përbëhet nga 3 rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën: *rregulli i parë* shprehë parimin e gëzimit paqësor të pronës; *rregulli i dytë* trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshtron atë kushteve të caktuara dhe *rregulli i tretë*, ua njeh të drejtën shteteve që të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar *ligje të tilla* që ato i çmojnë si të nevojshme për arritjen e një qëllimi (shih *mutatis mutandis*, rastet e GjEDNJ-së: *Sporrong dhe Lonngrot kundër Suedisë*, Aktgjykimi i 23 shtatorit 1982, kërkesa nr.7151/75; 7152/75, par.61; *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat nr.25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, Aktgjykim i datës 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbaixhanit*, kërkesa nr.40167/06, Aktgjykim i datës 16 qershor 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, kërkesa nr.53080/13, Aktgjykim i datës 13 dhjetorit 2016). Pra, sipas praktikës së GjEDNJ-së, në funksion të parimit të subsidiaritetit të ndërhyrjes së GjEDNJ-së, shteteve u lihet *një hapësirë e lirë e vlerësimit* përkitazi me shfrytëzimin dhe marrjen e pronësisë *duke i rregulluar me ligje* të veçanta këto çështje gjithnjë në përputhje me dispozitat e KEDNJ-së dhe standardet e krijuara nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së.

Koncepti i “*pasurisë*” dhe i “*pritjeve legjitime*”, kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me KEDNJ dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së. Termi “*pasuri*” sipas këtij neni përfshinë “*pasurinë ekzistuese*” apo “*asetet*”, përfshirë këtu edhe “*kërkesat*” për të cilat subjektet e së drejtës mund të argumentojnë se kanë së paku “*pritje legjitime*” që të arrijnë të gëzojnë të drejtë efektive pronësore (shih Aktgjykimet e GjEDNJ-së: *Jasiūnienė kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr.41510/98 e datës 06.03.2003; *MZT Larnica A.D. kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Kërkesa Nr.26124/02 e datës 30.11.2006; *Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Kërkesat Nr.71916/01, 71917/01 dhe 10260/02 e datës 02.05.2005; *Kopecký kundër Sllovakisë* Kërkesa Nr.44912/98 e datës 28.07.2004). Sipas nenit 1 të Protokollit Nr.1 i KEDNJ-së që zbatohet vetëm për *pasurinë ekzistuese* të një personi dhe *nuk krijon të drejtën e fitimit të pronësisë*, kurse në rrethana të caktuara, një “*pritje legjitime*” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së (shih, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i dt.13 dhjetor 2016, *Beltme Nagy kundër Hungarisë*, kërkesa Nr.53080/13, par.73 dhe 75, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Bronioëski kundër Polonisë*, kërkesa Nr.34443/96

par.129). Me fjalë të tjera, garantimi i të drejtës së pronës nuk e përfshin *per se* edhe të drejtën e fitimit të pronës.

Megjithatë, në mënyrë që një "*prishmëri*" të jetë "*legjitime*", ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjeshtë një shpresë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt juridik, siç është një vendim gjyqësor, që paraqet një interes të pronës në fjalë (shih, *Kopecky kundër Sllovakisë* [DHM], par.49-50; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], par.173; *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, par.103; *Ceni kundër Italisë*, par.39). Në të kundërtën, asnjë "*prishje legjitime*" nuk mund të konsiderohet se lindë kur ka një *mosmarrëveshje* sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të *ligjit vendor* dhe kur kërkesat e parashtruesve me pas refuzohen nga gjykatat kombëtare (shih, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [DHM], par.65; *Karachalios kundër Greqisë* (Aktgjykim), par.46; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], par.149).

- Lidhur me procedurën e eksproprijimit të parcelës kontestuese dhe efektet juridike të kësaj procedure -

Gjykata përgjatë procedurës provuese të udhëhequr në shqyrtimin kryesor, ka vërtetuar faktin se sipas aktvendimit të Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, të datës 06.07.1978, është bërë eksproprijimi i parcelës kadastrale, me ç'rast *e drejta e pronësisë* mbi këtë parcelë kadastrale ka kaluar nga O.(B).B, tek shfrytëzuesi i eksproprijimit - këtu e paditura Komuna e Prishtinës, konkretisht Ndërmarrjes Publike Komunale "Hortikultura".

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, Gjykata vlerëson se bazuar në kohën kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, bazuar në Aktvendimin e Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, i datës 06.07.1978, si ligj i zbatueshëm material në fuqi duhet t'i referohemi *Ligjit mbi Eksproprijimin*, i shpallur në Gazetën Zyrtare e ish KSAK - Nr.22 i datës 28.04.1978, *Ligji mbi Transferimin e Pronave të Paluajtshme e vitit 1965* i shpallur në Gazetën Zyrtare të ish-RSFJ-së Nr.43/1965.

Së këndejmi, Gjykata i referohet nenit 21 par.3 të Ligjit mbi Eksproprijimin, ku është përcaktuar se: "*Vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm, të pasurisë së patundshme të eksproprijuar, nëse shfrytëzimi i eksproprijimit në afatin prej 3 vitesh ç'prej se vendimi ka marrë formë të prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt*". Në anën tjetër, par.4 i këtij neni përcakton se: "*Pasi të kalojnë 10 vjet nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi*". Në bazë të dispozitave të lartcekura, ligjdhënësi ka paraparë mundësinë e anulimit të vendimit për eksproprijim dhe *kthimin e pronësisë së pasurisë së eksproprijuar tek pronari paraprak i parcelës*, mbi bazën e kushtit se shfrytëzuesi i eksproprijimit nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt, e që në rastin konkret kontestimor, mjaftueshëm është vërtetuar se deri më tani, pra pas kalimit të periudhës mbi 30 vjeçare, shfrytëzuesi i eksproprijimit, këtu e paditura pasurinë e shpronësuar nuk e ka shfrytëzuar në përputhje me qëllimin për të cilin edhe është eksproprijuar pasuria, pasi që nga dalja në terren me ekspert gjeodet është vërtetuar se ngastra objekt shqyrtimi është në posedim dhe shfrytëzim të paditësit.

Megjithatë, nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, rezulton se në bazë të procesverbalit Nr.7-464-32/78-4, të përpiluar me datë 08.06.1978 nga ana e Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, paraardhësi i paditësit - O.(B).B ishte njoftuar dhe është deklaruar për iniciimin e procedurës së shpronësimit, me ç'rast *nuk e kishte kundërshtuar eksproprijimin e pronës së tij, vetëm se kishte kërkuar kompensimin real*. Tutje, Gjykata gjen se Aktvendimi i Sekretariatit për Financa të Kuvendit Komunal të Prishtinës, 07 Nr.464-32/78, i datës 06.07.1978 është bërë i *formës së prerë*, sepse i njëjti përgjatë procedurës provuese nuk është vërtetuar se është goditur me mjetet juridike në dispozicion, ku Gjykata në rastin konkret i referohet nenit 322 par.2 të LPK-së, i cili përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Gjykata vlerëson se sipas procedurave të parapara dhe autorizuar *me ligj*, duke ndjekur *qëllim legjitim*, organi përkatës administrativ ka vlerësuar *nevojshmërinë* në funksion të *interesit publik* për eksproprijimin e parcelës lëndore dhe ka iniciuar dhe zhvilluar procedurën e eksproprijimit, elemente këto që e arsyetojnë ligjërisht *ndërhyrjen*, respektivisht kalimin e pavullnetshëm të *pronësisë* nga një subjekt i të drejtës private tek autoriteti publik, gjithnjë duke respektuar kushtet e parapara me ligj. Gjykata rikujton se padia lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë është niciuar me datë 07.07.2008, nga çka rezulton se padia është paraqitur pas më shumë se 30 viteve nga momenti kur paraardhësi juridik i paditësit O.(B).B ka qenë në *dijeni* mbi vendimin për eksproprijimin e pronës së tij.

Në bazë të këtyre rrethanave, Gjykata gjen se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që paraardhësi i paditësit të ketë kontestuar procedurën e shpronësimit në ndonjë formë brenda afateve të përcaktuara prej 3, respektivisht 10 viteve nga marrja e vendimit për eksproprijimin e parcelës kontestuese. Gjykata vlerëson se titullari paraprak i të drejtës së pronësisë të parcelës kontestuese - O.(B).B - gjyshi i këtu paditësit, ka lëshuar *çdo afat ligjor* të përcaktuar në nenin 21 par.4 të Ligjit mbi Eksproprijimin të vitit 1978, mbi bazën e të cilit është dashur të paraqesë brenda afatit ligjor objektiv *10 vjeçar* nga dita e vendimit mbi eksproprijimin e pronës së tij, e i cili afat për nga natyra juridike e tij paraqet *afat prekluziv* - lëshimi i të cilës krijon efektin juridik të *humbjes së vet të drejtës* (në këtë rast të drejtës së pronësisë). Nga kjo rezulton se në rastin konkret paraardhësi i paditësit ka pasur mundësi që brenda afatit të paraparë ligjor të natyrës prekluzive ta kërkonte *de-eksproprijimin/anulimin e eksproprijimit* dhe kthimin e të drejtës së pronësisë të paluajtshmërisë së eksproprijuar brenda këtyre afateve.

Thënë të gjitha këto, Gjykata sjellë në vëmendje parimin e disponibilitetit në procedurë kontestimore, i inkorporuar në nenin 2 par.1 të LPK-së, i cili parasheh që: *“2.1 Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*. Në frymën e parimit të lartëcekur, Gjykata vendosë meritorisht dhe në mënyrë autoritative vetëm brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, e që në rastin konkret kërkesa e vetme dhe kryesore e palës paditëse, i cili ka kërkuar mbrojtje gjyqësore konsiston në *vërtetimin e të drejtës së pronësisë*, kurse në anën tjetër *argumentum a contrario* Gjykata nuk kishte para vetes kërkesë për *kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar*.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësit i mbetet e drejta që të kërkojë kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar, sepse paraardhësit juridik i paditësit paluajtshmëria kontestuese i është marrë e drejta e pronësisë në bazë të procedurave të caktuara me ligjet e kohës në fuqi, ndërsa çështja e kompensimit eventualisht do të mund të caktohej sipas iniciimit të procedurave gjyqësore

përkatëse pranë gjykatës kompetente dhe varësisht rrjedhës së procedurës, sipas legjislacionit të zbatueshëm, eventualisht do të mund të caktohej kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar në qoftë se kompensimi nuk është caktuar, apo ish - pronari nuk e ka marrë kompensimin adekuat për atë paluajtshmëri.

- Pretendimi lidhur me fitimin e pronësisë mbi bazën e mbajtjes (parashkrimit fitues) -

Nga gjendja e vërtetuar faktike, Gjykata ka gjetur se parcela kadastrale kontestuese, deri në momentin e eksproprijimit ishte *në pronësi* të paraardhësit juridik - gjyshit të këtu paditësit O.(B).B, për çka Gjykata vlerëson se paditësi si pasardhës juridik i ish-titullarit të së drejtës së pronësisë, ka legjitimitet real aktiv të plotë në këtë çështje juridike kontestimore.

Një e drejtë e tillë si e drejtë subjektive - civile ka kaluar nga titullari paraprak - O.(B).B tek e paditura Komuna e Prishtinës sipas procedurës së eksproprijimit në bazë të aktvendimit të cilit Gjykata i është referuar më sipër, që paraqet mënyrë origjinere të fitimit të pronësisë. Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezulton që paditësi aktualisht është në posedim dhe shfrytëzim të parcelës kontestuese, mbi të cilën bazë edhe pretendon se përmes mbajtjes - parachkrimit fitues e ka fituar të drejtën e pronësisë.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, Gjykata ka gjetur se lloji i pronës kontestuese sipas ekspertizës gjeodezike evidentohet si pronë shoqërore. Në këtë rrjedhë, Gjykata i referohet *Ligjit mbi Transferimin e Pronave të Paluajtshme*, i shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së Nr.43/1965, ku sipas nenit 13 të të njëjtit, asnjë e drejtë subjektive civile, përfshirë edhe e drejta e pronësisë *nuk mund të fitohet mbi pronën shoqërore nëpërmjet parachkrimit fitues*. Të njëjtin rregullim ligjor e ka përcaktuar edhe Ligji Themelor mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr.6/1980), ku në nenin 29 të këtij Ligji parashihet që: *“Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parachkrimin fitues”*. Nga analizimi i dispozitave të lartëcekura, Gjykata vëren se ekziston një vazhdimësi kohore relativisht e gjatë e rregullimit ligjor, i cili e ka ndaluar fitimin e pronësisë me parachkrim fitues në pronë shoqërore. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se e drejta e *pronësisë* nuk mund të fitohet mbi bazën e parachkrimit fitues tek sendet e paluajtshme që janë kualifikuar si pronësi shoqërore, përfshirë këtu me mbajtje, përkatësisht shfrytëzim dhe posedim të paluajtshmërisë, në *çfarë do kohëzgjatje qoftë ajo*, sepse një mundësi e tillë *ex lege* është ndaluar. Fakti që e paditura, nga momenti i përfundimit të procedurës së shpronësimit e deri më tani nuk ka paraqitur kërkesë për lirim të paluajtshmërisë kontestuese ndaj paditësit, nuk paraqet fakt i cili apriori do të mund të konstituonte të drejtën e pronësisë në raport me këtë të fundit, nën dritën e konstatimit se kërkesa për konstituimin e kësaj të drejte është e orientuar ndaj paluajtshmërisë së evidentuar si pronë shoqërore.

Gjykata mori në konsideratë faktin se pala paditëse në cilësinë e provës ka prezantuar aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr.844/06, të datës 10.07.2006, nga i cili vendim pretendohet se vërtetohen faktet kyçe në këtë procedurë kontestimore. Në kontekst të çmuarjes së kësaj prove, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se vendimet nga praktika gjyqësore, të cilave palët ndërgjyqëse u janë referuar në funksion të mbështetjes së pretendimeve të ngritura, Gjykata nuk mund t’ia falë besimin e plotë në funksion të vendimmarrjes, për faktin se në sistemin kontinental, i cili gjen zbatim edhe në vendin tonë, vendimi duhet mbështetur në provat me të cilat vërtetohet ndonjë fakt konkret relevant që ka të bëjë me raportin juridik mes palëve të përfshira në procedure, në ndërlidhje edhe me të drejtën materiale të aplikueshme.

Mbi bazën e të gjitha vlerësimeve dhe arsyeve të elaboruara më sipër, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar në tërësi si e pa bazuar, andaj vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese, ndonëse në fjalë përfundimtare ka kërkuar shpenzimet e procedurës, nuk e ka parashtruar një kërkesë të tillë në formë të specifikuar, siç e parasheh dispozita e lartëcekur e nenit 463 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t'i tregojë shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.”*

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 142, 143, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.4747/23, datë 28.01.2025

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.